

Titulli i lëndës: STATISTIKË MJEKËSORE ME INFORMATIKË

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Drejtimi: Mjekësi e Përgjithshme/ Katedra e Mjekësisë sociale, Mjekësisë së punës dhe Mjekësisë Familjare
Titulli i lëndës:	STATISTIKË MJEKËSORE ME INFORMATIKË
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë , Semestri i I-rë
Numri i orëve në javë:	2+1+1
Kreditë ECTS:	Vlera në kredi ECTS: 5
Koha / Vendi:	Amfiteatri i ORL
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Merita Berisha merita.berisha@uni-pr.edu Prof.ass.dr. Sanije Hoxha-Gashi sanije.gashi@uni-pr.edu
Të dhënat kontaktuese:	IKSHPK nr. 12 Kosultimet me Profesor mbahen të Premte në IKSHPK prej ores 10:30-11:00
Përshkrimi i lëndës:	Njohtimi me metodologjinë statistikore, definicionet në informatikën mjekësore, organizimi i të dhënave në kompjuter, përgatitja e të dhënave për përpunim elektronik, përpunimi dhe prezentimi i të dhënave. Probabiliteti dhe shpërndarja normale e dukurisë. Studentet do të mësojnë të bëjnë llogaritjen e parametrevë statistikor si madhësitë mesatare, masat e variabilitetit, korelacionin linear, korelacionin e Spearmanit, studimin e serive kohore me metodën e trendit, njehësimin e ekuacionit dhe vijës së regresionit, koeficientit të tendencës. Gjithashtu do të mesohet për testimin e hipotezës me testet statistikore si T-testi dhe X^2 -testi.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është që përmes mëimit të statistikës, shkencës që hulumton dukuritë masive, variabile, studentët të aftësohen në: shfrytëzimin e statistikës deskriptive, testimin e hipotezës, analizen e të dhënave statistikore dhe shkruarjen e konkluzave. Përmes mëimit të informatikës mjekësore, shkencës që hulumton bartjen automatike të informatës mjekësore, studentët të aftësohen ta përdorin terminologjinë e informatikës mjekësore, njohjen e sistemeve operative dhe shfrytëzimin e programeve aplikative. Po ashtu të njohin terminologjinë e kujdesit shëndetësor dhe sistemet e klasifikimit, të njohin mënyrën e komunikimit me kompjuter, të dijnë ta shfrytëzojnë internetin për literaturë

	mjekësore, të kuptojnë rolin e sistemit të informimit shëndetësor në vendimmarrje dhe menaxhim.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> Aftësohen që të aplikojnë metodat e analizimit dhe prezentimit statistikor duke u bazuar në metodologjinë shkencore; Të njohin, përshkruajnë dhe interpretojnë në mënyrë kritike materialin e prezentuar statistikor në të gjitha modulet e këtij kursi; Të kuptojnë mundësitë dhe kufizimet e testeve si dhe kushtet që duhet plotësuar që testet të jenë valide; Të njohin sistemet operative dhe programet e ndryshme aplikative, mënyrën e komunikimit me kompjuter, të dijnë ta shfrytëzojnë internetin për literaturë mjekësore; Të punojnë në grup dhe të gjejnë burime të informatave shtesë për arritje të qëllimeve dhe të objektivave të caktuara dhe të jenë konfident kur punojnë dhe i shfrytëzojnë të dhënat statistikore;

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/15	30
Seminare	1	1/15	15
Kontaktet me mësime të ndihmuesit/konsultimet	1	1/3	3
Ushtrime në teren	4	1/5	20
Kollokfiume	1	1/3	3
Detyra të shtëpisë	1	1/5	5
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	1	1/5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	1/2	2
Projektet,prezentimet ,etj	1	1/2	2
Totali			125/ 5 ECTS

Metodat e mësimit:	Ligjerata, ushtrime përmes punës në grupe, seminare
Metodat e vlerësimit:	<p>Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <p>Vlerësimi i parë: 15%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 15%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi final: 60%</p> <p>Total 100%</p>

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Konceptet e ligjërimeve 2. Jekel, Katz, Elmore.: "Epidemiology, Biostatistics and Preventive Medicine" 2007 Sounders perkthyer ne shqip nga Guttenberg, Tiranë, 2013. 3. Gupta, J. "Understanding statistics: a guide for medical students." University of Leeds, 2013. 4. Nuhiu, R., Bazat e statistikës, Prishtinë, 1997 5. Beqiri E. Baza e informatikës, Prishtinë, 1999 6. Roshi, E, Hyska J, Bara P, Burazeri G, Kuneshka L, : "Statistika ", Tiranë, 2004
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Michael Harris and Gordon Taylor. , MEDICAL STATISTICS MADE EASY, United Kingdom 2003 2. David Machin, Michael J Campbell, Stephen J Walters,. MEDICAL STATISTICS, Fourth Edition, A Textbook for the Health Sciences, John Wiley & Sons Ltd 2007 Paca, A., Statistika, 2002 3. Paca, A., Permbledhje detyrash nga statistika, 2002 4. Pec, B., Matematika za nematematicare, Zagreb, 1985 5. Puvačić Z, : "Statistika u Medicini ", Sarajevo, 1997 6. "An Introduction to Medical Statistics" by M. Bland. Oxford Medical Publications 2004 <p>Linqet elektronike: http://www.statcan.ca/english/edu/power/ch8/variable.htm http://www.mieur.nl/mihandbook/r_3_3/handbook/home.ht http://www.coiera.com, Guide to Health Informatics</p>

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratis
Java 1:	Njohtimi me lëndën, roli dhe rëndësia e statistikës mjekësore dhe informatikës.
Java 2:	Metodologjia statistikore, objekti i studimit të statistikës, lloji i të dhënave statistikore Etapat e hulumtimit statistikor, grumbullimi dhe grupimi me kontrollim
Java 3:	Definicionet në informatikën mjekësore. Njohja me terminologjinë e cila përdoret në informatikën mjekësore. Informatat dhe llojet e tyre. Informimi dhe përpunimi i të dhënave.
Java 4:	Prezentimi i të dhënave statistikore – Tabelat statistikore Prezentimi grafik i të dhënave statistikore
Java 5:	Paisjet hyrëse dhe dalëse të kompjuterit, bllok-skema e kompjuterit
Java 6:	Organizimi i të dhënave në kompjuter Pregatitja e të dhënave për përpunim elektronik. Kodifikimi i të dhënave atributive. Shembuj të ndryshëm nga praktika mjekësore
Java 7:	Parametrat statistikor Numrat relativ

	Madhësitë mesatare
Java 8:	Sistemi informativ, principet dhe objekti i sistemit informativ. Burimet e të dhënave. Matja e informacionit, algjebra logjike, operacionet e algjebërës logjike. Mënyra e paraqitjes së karaktereve.
Java 9:	Probabiliteti dhe shpërndarja normale e dukurisë Masat e variabilitetit
Java 10:	Sistemi operativ i kompjuterit. Sistemi operativ windows Aplikimi i kompjuterëve në mjekësi, llojet e bazës së të dhënave. Baza e të dhënave në access.
Java 11:	Korelacioni (linear dhe i rangut) Studimi i serive kohore me metodën e trendit, njehësimi i ekuacionit dhe vijës së regresionit, koeficientit të tendencës
Java 12:	Mostra dhe gabimi standard
Java 13:	Softueri aplikativ. Programet aplikative MS Word dhe MS Exel. Rrjetat kompjuterike dhe interneti Gjuhët programuese
Java 14:	Testimi i hipotezës, nivelet e besueshmërisë, testet parametrike dhe joparametrike, t-testi Testet joparametrike Chi ² -testi
Java 15:	Rekapitulimi i lëndës dhe ligjerata përmbledhëse

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ligjeratat duhet të vijohen së paku 75%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime, seminare ose nuk është aktiv gjatë mësimin, duhet të hyj në kolokvium. Kalimi i dy provimeve formative është kusht për hyrje në provim. Studenti nuk pranohet në provim pa qenë në listen e paraqitjes së provimit SEMS dhe pa kartelet identifikuese